



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT



Ë-buletin

Gusht, 2018

SBASHK-u nis veprimet sindikale duke kërkuar realizimin e kërkesave



Protesta alarm Qeverisë se veprimet sindikale mund të përshkallëzohen

Duke shprehur kundërshtimin e arsyeshëm ndaj Projektligjit për pagat dhe me kërkesën konkrete që ky projektligj të kthehet për korrigjim, SBASHK-u ka nisur me veprimet sindikale duke organizuar protestë afër ndërtesës së Qeverisë. Në këtë protestë ishin të ftuar kryetarët e shoqatave sindikale të shkollave fillore, të mesme dhe njësisive akademike të Universiteteve të Kosovës, anëtarët e Këshillit Drejtues ... (faqe 4)

Këshilli Drejtues mbajti takimin e radhës

U analizua gjendja aktuale në arsim dhe u vendos për hapa konkret



Këshilli Drejtues i SBASHK-ut ka mbajtur takimin e radhës në të cilin është bërë një analizë e situatës në arsim... (faqe 6)

SBASHK përfaqësohet në takime të rëndësishme sindikale ndërkombëtare

Kërkohet solidarizim për tejkalimin e sfidave të shumta



Delegacioni i SBASHK-ut i udhëhequr nga Kryetari z.Rrahman Jasharaj, ka marrë pjesë në Simpoziumin Ndërkombëtar me temën "Globalizmi, Arsimimi dhe Sindikatat", ... (faqe 7)

SBASHK në komunikim të vazhdueshëm me ETUCE

Informatë për protestën dhe falënderim për... (faqe 9)



Intervistë me edukatoren Fitnete Jakupi.

Fitnetja është edukatore e vyer dhe anëtare e veprimitare e SBASHK-ut. Ajo ndjehet mirë në profesionin e saj, por pranon se nuk është e lehtë të jesh edukatore sepse punohet me filizat e këtij vendi dhe kërkohet mund e sakrificë për të ... (faqe 3)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Me arsimin drita triumfon mbi errësirën



arsimin e radhiti në pozitë jo të mirë. Ne zhvilluam shumë takime me Ministrat Bytyqi e Jagcilar dhe me përfaqësues tjerë të Qeverisë duke afruar argumentet tona, të cilat nuk janë përfillur në masë të duhur. Si reagim të arsyeshëm ndaj kësaj SBASHK-u nisi me veprime sindikale duke organizuar edhe protestë, në të cilën ishin të ftuar vetëm kryetarët e shoqatave sindikale të shkollave, të njëjstëve akademike dhe Këshilli Drejtues e kryesia. Protesta zëshëm kërkoi nga Kryeministri Haradinaj që të korrigjohet Projektligji për pagat dhe që punëtorët e arsimit e të kulturës të jenë të radhitur në vend meritore në këtë Ligj.

SBASHK-u uron që Qeveria ta kuptojë drejtë këtë thirrje dhe të veprojë sepse në të kundërtën SBASHK-u do të vazhdojë me veprimet sindikale dhe mund të arrijë çështja deri të greva e përgjithshme në tërë sistemin arsimor dhe në institucionet e kulturës.

SBASHK-u pret që dialogu të jetë i frytshëm dhe të realizohen kërkesat tona. Qeveria ka obligim të angazhohet për gjetje të zgjidhjeve sepse është përgjegjëse për mirëvajtjen e punës në arsim e kulturë.

Dijes i është dhënë rëndësi e madhe që nga kohët e lashta. Edhe besimet fetare e nxisin njerëzimin për dije duke thënë se dijen duhet kërkuar deri në Kinë. Institucionet shtetërore që mendojnë për ardhmërinë edhe më të mirë e kanë prioritet arsimimin e gjeneratave dhe bëjnë çmos që të kenë mësues që ndjehen të përkrahur nga institucionet dhe të shohin se Qeveria e Republikës së Kosovës u ka caktuar vend meritore në Ligjin pagave, por edhe në shoqëri në tërësi.

Qeveria nuk ka arsyetuar sa duhet deklarimin se arsimin e ka prioritet dhe këtë e dëshmoi edhe Projektligjin për pagat sepse

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me edukatoren Fitnete Jakupi

Nuk është i lehtë profesioni i edukatores



Fitnetja është edukatore e vyer dhe anëtare e veprimtare e SBASHK-ut. Ajo ndjehet mirë në profesionin e saj, por pranon se nuk është e lehtë të jesh edukatore sepse punohet me filizat e këtij vendi dhe kërkohet mund e sakrificë për të qenë çdo herë në nivel. Fitnetja lavdëron

angazhimet dhe arritjet e SBASHK-ut.

Arsmimimi sot:

Kush është Fitnete Jakupi?

Fitnetja:

Fitnete Jakupi është edukatore në institucionin parashkollor "Ardhmënia" në Prishtinë. Punoj bashkë me kolegët e mija me zell dhe bëjmë çmos që të jemi në nivel të detyrës prej edukatoreje, detyrë kjo as pak e lehtë, por unë dhe gjithë edukatorët tjerë e duam profesionin tonë sepse punojmë me filizat e këtij vendi dhe ato meritojnë gjithë angazhimin, përkushtimin dhe dashurinë prindërore.

Arsimimi sot:

Cilat janë arsyet kryesore që ndikuan të bëheni anëtare e SBASHK-ut?

Fitnetja:

Punëtorët duhet të jenë të mbrojtur në mënyrë që të mos u cenohen të drejtat e tyre ligjore. Këtë mbrojtje është duke e bërë SBASHK-u. Po ashtu kjo sindikatë ka treguar gjithmonë unitet dhe përkushtim në realizimin e kërkesave të punëtorëve të arsimit e të kulturës. Kjo ka bërë që edhe unë dhe shumë punëtorë të tjerë të arsimit të anëtarësohemi në SBASHK. Tani jemi më shumë se 22.000 anëtarë dhe ky numër sa vjen e shtohet.

Arsimimi sot :

A jeni e pajisur me kartelë të SBASHK-ut dhe a e shfrytëzoni atë?

Fitnetja:

Po, jam e pajisur me kartele dhe e shfrytëzoj në bazë të nevojës dhe mundësisë. Kjo është një mundësi shtesë për gjithë anëtarësinë që përmes kartelës të gëzojnë zbritje çmimesh për shërbime në më shumë se 100 biznese private dhe institucione private shëndetësore e rekreative.

Arsimimi sot:

Sa është i vështirë profesioni i edukatores sot?

Fitnetja:

Profesioni i edukatores në ditë t e sotme mund të konsiderohet si i vështirë për shkak se edukatorët sot nuk kanë autonomi edukimi të plotë tek nxënësit e tyre. Nuk është e lehtë të jesh edukatore sepse punohet me filizat e këtij vendi dhe kërkohet mund e sakrificë për të qenë çdo herë në nivel.

Arsimi sot:

Cili është roli momental i femrës në SBASHK?

Fitnetja:

Roli i femrës në SBASHK konsideroj që nuk është sa duhet i dukshëm . Mendoj se femra e punësuar në sistemin arsimor duhet të jetë edhe më aktive në angazhimet e SBASHK-ut dhe në veprimtaritë sindikale në tërësi.

Arsimimi sot:

Çka do të veçonit nga aktivitetet dhe arritjet e SBASHK-ut?

Fitnetja:

Janë të shumta arritjet e SBASHK-ut. Nënshkrimi i Kontratës Kolektive të Arsimit, mbrojtja e të drejtave legjitime të punëtorëve, ngritja e zërit në emër të anëtarësisë . Angazhimet e shumta që me dialog të zgjidhen çështjet e ngritura, besimi i anëtarësisë, uniteti i madh. Janë vetëm disa nga arritjet e SBASHK-ut.

Arsimimi sot:

Çka i sugjeroni SBASHK-ut që të fokusohet me shume ne angazhimet e veta?

Fitnetja:

SBASHK-ut i sugjeroj që të vazhdojë të nënshkruaj marrëveshje bashkëpunimi me bizneset private për të siguruar benefite/lirime në shërbimet dhe produktet e tyre e që i përdorin punëtorët e arsimit

Arsimimi sot :

A keni diçka për te shtuar?

Fitnetja

Shpresoj që SBASHK do ta vazhdoj angazhimin e tij në mbrojtjen e të drejtave ligjore të punëtorëve të arsimit si dhe të krijojë kushte edhe më të favorshme për ta.

Gjatë muajit

SBASHK-u nis veprimet sindikale duke kërkuar realizimin e kërkesave

Protesta alarm Qeverisë se veprimet sindikale mund të përshkallëzohen

Duke shprehur kundërshtimin e arsyeshëm ndaj Projektligjit për pagat dhe me kërkesën konkrete që ky projektligj të kthehet për korigjim, SBASHK-ua nisur me veprimet sindikale duke organizuar protestë afër ndërtesës së Qeverisë. Në këtë protestë ishin të ftuar kryetarët e shoqatave sindikale të shkollave fillore, të mesme dhe njësive akademike të Universiteteve të Kosovës, anëtarët e Këshillit Drejtues, përfaqësuesit sindikal të institucioneve të kulturës dhe kryesia e SBASHK-ut.

të Parlamentit të Kosovës, të cilat fillimisht i lexonte veprimtari sindikal Arif Elezaj.



Pas kësaj ata kanë qëndruar afër Qeverisë së Kosovës. Atyre u është drejtuar kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj duke treguar se për shqetësimet e tyre kanë informuar Komitetin e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, Internacionalen Botërore të Arsimit dhe BSPK-në dhe se nga të gjitha ata kanë marrë mbështetje të fuqishme.



Pjesëmarrësit e protestës kanë arritur me kohë nga e tërë Kosova në Prishtinë dhe janë nisur në mënyrë të organizuar nga Sheshi "Zahir Pajaziti" për t'u ndalur afër ndërtesës së Qeverisë. Gjatë marshimit dinjitoz ata njëzëri kanë brohoritur kërkesat e tyre drejtuar Kryeministrit Haradinaj, institucioneve dhe deputetëve

"Kjo protestë është alarm i fundit drejtuar Qeverisë që ta kuptojë se situata është serioze dhe të veprojnë menjëherë duke e tërhequr Projektligjin e pagave për ta kthyer në Ministrinë e Administratës Publike për ta korigjuar në mënyrë që sektori i arsimit të ketë vend merit. Në të kundërtën SBASHK duke dëgjuar zërin e punëtorëve të arsimit e

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

kulturës do të vazhdojë me veprime sindikale të cilat do të jenë edhe më radikale e duke mos përjashtuar edhe grevën e përgjithshme e cila do të paralizojë tërë sistemin arsimor”, ka deklaruar Jasharaj për të vazhduar : “Pse protestë të shtunën, kur është ditë pushimi, do të pyes dikush. SBASHK-u po organizon këtë protestë pikërisht të shtunën . Disa nga prindërit dhe një pjesë e shoqërisë civile janë deklaruar se përkrahin fuqishëm kërkesat legjitime të SBASHK-ut , por kanë kërkuar nga ne , që para se të shkohet në greva të bëhen veprime të tjera sindikale. Ne vepruam ashtu. Sot nuk po pengohet proces mësimor dhe të shohim nëse pas këtij reagimi sindikal sa do të reflektojë Qeveria. Nëse jo atëherë ne nuk do të kemi rrugë tjetër, por do të vazhdojmë me veprime sindikale duke respektuar zërin e punëtorëve të arsimit e kulturës. Pra, do të veprojmë ashtu si vendosin ata.



Në vazhdim të këtij veprimi sindikal profesori i Fakultetit të Edukimit, prof. dr. Atdhe Hykollli ka lexuar pjesë nga letra mbështetëse që SBASHK-ut i kishte arritur nga i Komiteti i Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës. Ky union që përfaqëson 11 milionë punëtorë të arsimit.

Edhe kryetari i BSPK-së, z. Avni Ajdini ishte pjesë e kësaj proteste bashkë me kryetarë të disa prej federatave të sindikatave të Kosovës. Ai duke shprehur përkrahjen e plotë të BSPK-së për angazhimet dhe veprimet e SBASHK-ut ka kërkuar nga Kryeministri Haradinaj dhe Qeveria që të zhvillojnë që tani dialog kuptimplotë me SBASHK-un dhe të gjejnë zgjidhje meritore për çështjet e ngritura, sepse si tha ai, në të kundërtën veprimet sindikale do të përshkallëzohen.



Nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala ka lexuar kërkesën drejtuar Kryeministrit të Republikës së Kosovës , z. Ramush Haradinaj duke kërkuar korrigjimin e Projektligjit për pagat, gjegjësisht ngritjen meritorë të koeficienteve për sektorin e arsimit e kulturës dhe angazhimin për zbatimin në tërësi të Kontratës Kolektive të Arsimit.




kishte rrjedhë të qetë dhe në përfundim të saj pjesëmarrësit janë shpërndarë në mënyrë të dinjitetshme duke ruajtur imazhin pozitiv të figurës së punëtorëve të arsimit e kulturës.

Kërkesat e SBASHK-ut

I Nderuar Kryeministër, e nderuar Qeveri e Republikës së Kosovës këto janë kërkesat e SBASHK-ut:

1. Të ngritën koeficientet e parapara në Projektligjin e pagave, për punonjësit arsimor dhe të kulturës për 30%.
2. Të zbatohet në tërësi Kontrata Kolektive për Arsimin e Kosovës e nënshkruar nga MASHT e SBASHK.

SBASHK pret angazhim të shpejtë e konkret të Qeverisë lidhur me këto kërkesa në të kundërtën do të jemi të shtyrë të vazhdojmë me veprime sindikale duke respektuar vullnetin dhe zërin e punëtorëve të sistemit arsimor, të shkencës dhe Kulturës.



ETUCE
European Trade Union Committee for Education
EI European Region

To: UESCK-SBASHK, ETUCE member organisation in Kosovo¹

Brussels, 7 September 2018
Ref.: SF/vd/10000

Subject: Solidarity with the ETUCE member organisation in Kosovo

Dear colleagues,

With this letter, ETUCE, representing 132 education trade unions at all levels of education in 51 countries, expresses its support with you in the forthcoming warning strike to demand the government of Kosovo to negotiate with the education trade union, the Union of Education, Science and Culture of Kosovo (UESCK-SBASHK), regarding the salary ranking of education personnel in the Bill on Salaries in public sector.

According to you, the Bill which is to be presented for approval by the Parliament does not take into consideration any of the proposals made by the education trade union. ETUCE reiterates its solidarity with you in defending teachers' interests and in demanding a pay rise for teachers with this protest action in front of the buildings of the Government of Kosovo tomorrow, on 8 September 2018.

In early June 2018, the members of the ETUCE Bureau amplified the argument and demands of education trade unions to fully establish social dialogue in order to drive a necessary pay rise for education workers by contributing to the campaign "Europe needs a pay rise. It's time for our recovery".

As experience shows, the attractiveness of the teaching profession is directly linked to teachers' salaries. Low salary of teachers is the first negative factor leading young graduates to choose another profession and results in teacher shortages.

As a potential candidate country to the European Union, Kosovo should also take into account the new EU Strategy "European Education Area 2025", wherein the EU Leaders acknowledge that [...] "offering them [teachers] excellent training and attractive perspectives for their professional development and remuneration" [...] is an important measure to preserve the teaching profession.

ETUCE stands firmly with you in your fair demand for decent salaries for teachers in Kosovo. We wish SBASHK that your protest action leads to comprehensive negotiations with meaningful outcomes.

In solidarity,

S. Flocken

Susan Flocken
European Director

¹ This designation is without prejudice to positions on status, and is in line with UNSCR 1244/1999 and the ICJ Opinion on the Kosovo declaration of independence.

Presim angazhimin dhe përkushtimin Tuaj i nderuar Kryeministër.

Me respekt,

Kryetari: Rahman Jasharaj.

Këshilli Drejtues mbajti takimin e radhës U analizua gjendja aktuale në arsim dhe u vendos për hapa konkret



Këshilli Drejtues i SBASHK-ut ka mbajtur takimin e radhës në të cilin është bërë një analizë e situatës në arsim dhe e përgatitjeve për fillimin këtij viti shkollor.



Në hapje të këtij takimi kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj i ka informuar të pranishmit lidhur me aktivitetet që SBASHK-u ka zhvilluar edhe gjatë gjithë kohës së pushimeve duke u takuar me Ministrat Bytyqi e Jagçilar, me koordinatoren për punën e institucioneve, Besnik Tahiri dhe me anëtarë të Komisionit për Arsim e me deputetë në përpjekje që

Projektligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqip për vitet e 90-ta, pas debatit të stërzgatur publik, të shkojë në Parlament për leximin e dytë dhe për votim nga deputetët. Po ashtu këto angazhime janë bërë edhe në përpjekje për të vazhduar me ndryshimet në Projektligjin pagave me qëllim që punëtorët në sektorin e arsimit dhe atë të kulturës të kenë vend meritor në këtë Ligj.



Detaje nga këto angazhime dhe informacione lidhur me temat e debatuar në këto takime i ka dhënë menaxheri për financa e administratë dhe Këshilltar

për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri. Këshilli Drejtues pas një debati konkret ka autorizuar kryetarin dhe kryesinë që të veprojnë sipas situatës dhe të dëgjojnë, si gjithmonë, zërin e punëtorëve të arsimit e kulturës.

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj ka kërkuar nga anëtarët e Këshillit Drejtues që bashkë me kryetarët e nivelit komunal të sindikatave të angazhohen edhe më shumë në mënyrë që çështjet që kërkojnë zgjidhje në nivel institucioni arsimor a në nivel komune të shtrohen atje dhe nëse zgjidhja bëhet e pamundur atëherë të kërkohet angazhim edhe i SBASHK-ut në qendër, ngase, siç tha kryetari, jo rrallë, anëtarët tonë vijnë në qendër për të kërkuar mbështetje në zgjidhjen e një problemi, problem ky që duhet të gjej zgjidhje në nivelin komunal.

Anëtarët e Këshillit Drejtues janë shprehur se SBASHK-u duhet të vazhdojë me trajnimet dedikuar anëtarësisë.

SBASHK përfaqësohet në takime të rëndësishme sindikale ndërkombëtare **Kërkohet solidarizim për tejkalimin e sfidave të shumta**

Delegacioni i SBASHK-ut i udhëhequr nga Kryetari z.Rrahman Jasharaj, ka marrë pjesë në Simpoziumin Ndërkombëtar me temën "Globalizmi, Arsimit dhe Sindikatat", i cili u mbajt në Stamboll, me pjesëmarrjen e delegacionet e 76 shteteve nga mbar bota me 176 pjesëmarrës.



Në këtë simpozium pas fjalës hapëse të Kryetarit të Sindikatës së Arsimit të Turqisë Ali Yalçin (Egitim-Bir-Sen), të pranishmit i përshëndeti edhe Ministri i Arsimit të Turqisë Prof.Dr.Ziya Selcuk, dhe i inkurajoi sindikata që të bashkëpunojnë me ministrit e tyre për të tejkaluar çdo sfidë me të cilat përballët arsimit, si dhe kanë folur për rëndësinë e këtij takimi. Gjate këtij simpoziumi Kryetari i SBASHK-ut po mban takime me koleget e shume shteteve pjesëmarrëse ku po diskuton për format e bashkëpunimit të SBASHK-ut me sindikatat e arsimit të këtyre shtete



ve.Folësit e panelit janë nga përfaqësues të sindikalistëve dhe arsimit ndërkombëtar, të cilët janë ekspertë në arsim dhe sindikalizëm. Në këto punëtori janë shtruar tema të ndryshme dhe të gjithë pjesëmarrësit kanë shkëmbyer ide dhe rezultatet e seminareve janë vlerësuar në asamblenë e përgjithshme.

Duke përcjellë përshtypjet nga ky takim i rëndësishëm ndërkombëtar, delegacioni i SBASHK-ut veçon se kudo në botë arsimit po përballlet me sfida dhe se institucionet shtetërore duhen shtuar mbështetjen për arsimin dhe duhen ndihmuar mësuesit që më lehtë të hapëroj në misionin e tij human në përballje me sfidat dhe ecjen në kohë kur po ndodhin zhvillime të

shpejta e të mëdha teknologjike.



Duke e pasur parasysh se zhvillimi i teknologjive të komunikimit dhe informacionit, internetit dhe medieve sociale rrjetet kanë sjellë ndryshime të mëdha në jetën shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore. Këto zhvillime, të cilat janë definuar si proces i

globalizimit, gjithashtu kanë përmirësuar mundësi për



njerëzit që të kenë qasje në përvoja dhe informacione diku tjetër në botë. Në të njëjtën kohë, këto mundësi kanë sjellë botën në një treg global dhe një fushë konkurruese dhe sukses edhe në fushën e arsimit cilësor.

Vazhdon përfaqësimi i SBASHK-ut në aktivitete ndërkombëtare **Takime të rëndësishme në Bruksel, Estoni e Athinë**



European Trade Union Committee for Education
Comité syndical européen de l'éducation



Education International - European Region

Duke respektuar angazhimet dhe arritjet e vazhdueshme të SBASHK-ut, Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës e ftojnë sindikatën tonë të marrë pjesë në të gjitha takimet e aktiviteteve të rëndësishme sindikale kudo organizohen ato. Fryt i këtij respekti janë edhe takimet që do të mbahen me përfaqësues të Sindikatave të Arsimit të Evropës në Bruksel, Estoni e Athinë. Në këto aktivitete do të bëhet një analizë e situatës aktuale në arsim kudo në Evropë dhe do të nxirren edhe ide të reja e përfundime lidhur me veprimet konkrete sindikale në shërbim të realizimit të kërkesave të anëtarësisë dhe në ruajtjen e personalitetit të mësuesit nga tendencat për zhvleftësimin e rëndësisë së profesionit të tij.

Në Bruksel do të mbahet Konferenca përmblyëse "Sindikatat e Arsimit për profesionin e mësimit dhe forcimi i kapaciteteve të sindikatave për të përfaqësuar nevojat profesionale të mësimit në dialogun social". Në këtë ngjarje të rëndësishme për sindikata e arsimit të Evropës do të marrë pjesë edhe delegacioni i SBASHK-ut, i cili do të jep kontribut në punimet e kësaj Konferencë dhe do të zhvillojë shumë takime me përfaqësues të sindikatave të arsimit nga shumë shtete të Evropës dhe po ashtu do

të këtë takim edhe me drejtorin e përgjithshëm të Komitetit të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, znj. Suzan Flocken. Po ashtu do të vizitohet edhe selia e Internacionales Botërore të Arsimit për t'u takuar me sekretarin e përgjithshëm të EI-së, që përfaqëson 32 milionë mësimit nga e tërë bota.

Në Bruksel delegacioni i SBASHK-ut do të shpalojë edhe shqetësimet aktuale duke shpallur angazhimet dhe sfidat dhe duke falënderuar ETUCE-në për mbështetjen e vazhdueshme.

Në Estoni përfaqësuesi i SBASHK-ut, që është anëtar i Komitetit të Përhershëm për Arsimin e Lartë, z. Atdhe Hykolli do të marrë pjesë në takimin e radhës dhe do të informojë zyrtarët e ETUCE-s për situatën aktuale në arsimin e lartë të Kosovës në veçanti dhe për gjendjen në tërë arsimin e shtetit tonë.

Një takim tjetër tepër i rëndësishëm, e në të cilin krahas kolegëve sindikalistë nga e tërë Evropa, do të jenë edhe përfaqësuesit e SBASHK-ut, është ai në Athinë. Organizatori ka paraparë që para Konferencës të zhvillohen një varg aktiviteteve me tematikë arsimore e sindikale.

Informatë për protestën dhe falënderim për mbështetjen



Education International
Internationale de l'Éducation
Internacional de la Educación

ETUCE

European Trade Union Committee for Education
EI European Region

SBASHK-u vazhdon të mbaj komunikim të rregullt me organet udhëheqëse të Komitetit të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës me seli në Bruksel. Ata kanë kërkuar që të jenë të informuar për aktivitetet në mënyrë që t'i mbështesin ato. Në informatën e SBASHK-ut drejtuar ETUCES thuhet:

Udhëheqësit sindikal të Çerdheve, Shkollave fillore, Shkollave të mesme, Universiteti dhe Kulturës sot protestuan për paga të dinjitetshme në ligjin e pagave të shërbyesve publik që pritet të miratohet nga Parlamenti i Kosovës dhe kërkuan dialog gjithëpërfshirës social në arsim para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës. Protestuesit me moton "**Duam vend meritore në ligjin e pagave**" duke brohoritur parullat që mbanin në duar "Kryeministër ktheje ligjin e pagave për korrigjim", "Ministër punonjësit e arsimit e kulturës duan trajtim meritore", "Kryeministër në jemi zëri i 27.000 punëtorëve të arsimit e kulturës - dëgjoje këtë zë", "Deputetë mos lejoni të mbyllën shkollat", "Ju nuk do të ishit pa ne", "Kryeministër dhe ju ministra mendoni për mësuesit tuaj", "Pa arsim ardhmëria e një vendi është e errët", ata marshuan neper sheshin Nëna Terezë drejt ndërtesës së Qeverisë së Kosovës.

Protesta u organizua për të kundërshtuar dispozitat e Ligjit për Pagat në sektorin publik, të cilat pritet të miratohet në kuvendin e Kosovës, ku punëtorët arsimor janë të ranguar në koeficientin 2 nga koeficienti më i lart që është 12. Në krye të protestave, ishte Rrahman Jasharaj kryetar i SBASHK-ut i cili në emër të gjithë punëtorëve të arsimit dhe kulturës ka kërkuar që qeveria ta korrigjoj Projektligjin e pagave për t'ju dhënë vend meritore punëtorëve të sistemit të arsimit dhe të kulturës të Republikës së Kosovës. Ai ka kujtuar qeverinë se ky është vetëm fillimi i veprimeve sindikale dhe nëse qeveria nuk reflekton në realizimin e kësaj kërkesë, atëherë i tërë sistemi arsimor do të paralizohet.

Protestën e kanë mbështetur edhe të gjitha federatat sindikale në krye me kryetarin e konfederatës së bashkimit të sindikatave të pavarura (BSPK), z.Avni Ajdini.

SBASHK-u falënderon Komitetin e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës për mbështetjen e vazhdueshme dhe pret që kjo mbështetje të jetë e pranishme edhe në të ardhmen.